

ANA SHAHINI

**ELEMENTE TË TRADITËS POPULLORE NË ROMANIN
“LUMI I VDEKUR” TË J. XOXËS**

Rrëfimi folklorik ka ndikuar bindshëm që në gjenezën e romanit shqiptar duke iu referuar pikësëpari gjenezës së **letërsisë gojore**. Ky lloj rrëfimi haset që në romanin sentimental të midis dy luftërave botërore, që kanë qenë folklorike dhe duke u zgjeruar në romane me etose të ndryshme të folklorit.

Në romanin e Jakov Xoxës gjallon folklorizmi, sepse çdo trill nis me epizmin e vet folklorik, si në ndërtimin e fabulës romaneske, e cila për mendimin tim duket si një përrallë gjigante me të gjithë aktantët e saj, ashtu edhe në ndërtimin e karaktereve.

Kudo në roman shpalosen elemente të rrëfimit folklorik, në fjali autoriale, të folurit të personazheve, kurse po të bësh një analizë më të hollësishme të gjuhës përvoja pararendëse të shpie retrospektivisht te folklori si dhe tek përralla.

Në romanet e realizmit socialist, si dhe në romanin “Lumi i vdekur” të Xoxës, është një fond e tërë sentencash dhe fjalësh të urta që barten si begati gjuhësore dhe pavarësisht nga diagrami i vijës rrëfimore, në rrëfimin e tyre dhe në gjuhën e folur të personazheve, ndeshim një begati kujtimesh të shkurtra, por popullore në planin krijues.

Është në natyrën e romanit modern që rrëfimi folklorik të marrë një konotacion tjetër të rrëfimit, **si rrëfimi folklorik të marrë një kuptim të ri**, për shembull të marrë domethënie historike, si në shembullin sipërpërmendur duke iu referuar kështu mendimit të Aristotel Micit: *“Një veçori themelore e romanit është realizmi i thellë i jetës. Ky realizëm buron nga intuita e thellë e shkrimtarit dhe kalon në përgjithësim artistik. Vlerat realiste të kësaj vepre rriten shumë, sepse autori ka vendosur një raport të drejtë midis materialit bruto dhe fantazisë krijonjëse. Vendosja e një raporti të drejtë midis*

*këtyre dy burimeve në përpilimin harmonik të një vepre është kërkesë artistike.*¹

Ngjyrimi i zërit të rrëfimitarit është përplot me timbra të zërit të rrëfimit popullor, ndeshim një mori këngësh folklorike, madje hasim elemente të rrëfimit historik. Në romanin shqiptar janë të njohur romanet sentimentale në mes dy luftërave botërore, kurse vetëm në vitet shtatëdhjetë dolën romanet e mirëfilltë që me strukturën e vet rrëfimore, tentojnë të bëjnë modernimin e rrëfimit.

Tregues për rolin që luan tradita popullore në tekstet e Xoxës, është edhe fakti që, Jakov Xoxa **përdori që në paratekst referenca eksplicite nga folklori**, përmendja e traditës popullore si hipotekst shfaq edhe pozicionin e shkrimtarit që e sheh atë si model, ku ai gjen më të mirën për procesin e tij krijues.

Ndërmjet paratekstit dhe tekstit, interesant është parateksti me origjinë folklorike është këngë popullore, si ndërfaqje të plota ashtu si janë ato në pasurinë folklorike.

Interteksti i drejtpërdrejtë oral realizon universalitetin e ndjenjës së dashurisë së krijuar në një ambient shqiptar.

Intertekstualitetin, mes këtij romani, dhe oralitetit mund ta shikojmë në dy plane, në atë sintagmatik dhe paradigmatic.

Ndikimi nga tradita popullore mund të shihet në planin sintagmatik, në mënyrën e vendosjes, lidhjes së fjalëve, frazave. Kur flasim për ndikimin në këtë plan merret parasysh **leksiku i përdorur si dhe teknikat e kombinimit të tyre në fjalë të urta, shprehi të jetës së përditshme...**

- *Ani mos u kthefsha, pa të më shohë ai.* (f. 283)
- *Vjen nga prapa diellit dhe fut hundët në çifligun tim sikur të jetë pa zot.* (f. 283)
- *Ty o bej të ngrënshin çizmet nga shëllira.* (f. 286)
- *Ah qeni i qenit po s'të kripa mollaqet me një okë saçma unë ty mos më thënçin Vroma.* (f. 287)
- *Na, ma rrove bythën.* (f. 287)

¹ A. Mici, *Mbi veçoritë ideo-artistike të romanit "Lumi I vdekur"*, Nëntori, nr. 2, 1968, Tiranë, f. 177-182.

- *I hipi gjaku në tru. (f. 289)*
- *Thirri me sa pat në kokë. (f. 289)*
- *E ku ja këndon mendjen kafshës. (f. 290)*
- *Ah unë e mjera që s’pashë një dritë të bardhë as në derë të prindit as në derë të burrit. (f. 302)*
- *zot mos e lënç fshatin pa prift e priftëreshë. (f. 304)*
- *Prifti nuk ia vuri veshin. (f. 305)*
- *Pusho se më plase me këto të tuat. (f. 305)*
- *Hipu tenxhereve të tua po më le rehat. (f. 305)*
- *A u djegsh në gropë të gëlqerës ti, pa! (f. 305)*
- *Gjallë jemi po më të vdekurit merremi. (f. 305)*
- *Si qoftë shkruar o bëftë. (f. 310)*
- *U, më marsh të keqen e mu bëfsh kurban. (f. 311)*
- *Shiko mire ti, harramzës i dreqit se jua kam bërë bënë unë. (f. 311)*
- *Bëjnë gjumë që bëfshin gjumin e madh o zot. (f. 313)*
- *U më marrsh të keqen. (f. 315)*
- *Arakopiset çaireve dhe dobiçi i mbetet fshatit. (f. 315)*
- *U, më raftë një pikë moj delenxhenshkë që këndon kështu në sy të burrave. (f. 316)*
- *Tyt moj gojë këllirë. (f. 316)*
- *Gaz pastë në zemër. (f. 317)*
- *zot krishti vet në kryq. (f. 320)*
- *E zeza unë as për të qarë me lot nuk e qaj dot. (f. 346)*

Mënyra sesi flasin personazhet njëri me tjetrin dhe me veten, mënyra skenike që realizohen bisedat në takimet në grup dhe në marrjen e vendimeve, ka shenja të **diskursit popullor**. Jakov Xoxa, madje, zgjedh edhe formën e diskursit, që shfaq shenja eksplicite të rrëfimit popullor, ndonëse e transmodelon atë, duke i dhënë shenjat e diskursit autorial.

Ndikimi nga tradita popullore, ndjehet në krijimin dhe rrëfimin e ngjarjeve, dhe në **mënyrën sesi realizohen përshkrimet e botës së jashtme dhe të brendshme**.

Mënyra e rrëfimit të ngjarjeve të retrospektivës është tipike si në rrëfimin popullor, sikur komunikimi është direkt dhe dikush

po dëgjon. Këtë kontakt të shkurtër, që shkrimtari e improvizon, e vërejmë në mënyrën sesi gjatë rrëfimit ai e ndërpret atë, nëpërmjet ndonjë modifikimi ose edhe ndonjë komenti. Këtë e shfaq hapur, edhe në orvatjen që dyshimin, mosbesimin e tij për atë që rrëfen t'ia përcjellë qartazi lexuesve.

Janë të shpeshta rastet e vënies në gojën e personazheve të romanit, të shprehjeve frazeologjike dhe fjalëve të urta, formulimeve që ngjajnë si mesazhe fabulash që të afrojnë me diskursin popullor.

Fjalët e urta rrisin semantikisht tekstin dhe e bëjnë atë më të thellë e më të besueshëm. Gjuha e krijimeve popullore, në funksion të autoriales, transfigurohet në një shenjë tjetër, që pasurohet me kuptime krejt të reja të gjendura më parë.

- *Kështu është edhe me parmendën: ç'hap plori me veshë, e shtypin dhe e sheshojnë këmbët e kaut, e të pandari që vijnë pas, dhe toka ruan vlagë si ti ketë shkuar lesa. Ndërsa, plugu e hedh dheun vetëm me një krah, kahu shkel në vijën e brazdës, e njeriu nën ugarë, kështu që toka e porsa lëruar nuk shtypet dhe vlagë mban më pak..si puna e të shkruarit të sotëm, o zoti Lipi, apo jo? Ç'shkruan kalemi është ligj e nuk shkel e nuk fshin gjë...më. (f. 112)*

- *Po, kur s'ke arra në **mal**, pse bën dava me çakenjtë? (f. 230)*

- *Hej, ç'na zuri këtu mbledhur, si dhentë në vathë ...prit kur të na zërë gërshërën tashi e të na qesh..se nuk na mbledh ai, po të kishim ndodhur shpërndarë. (f. 271)*

- ***Që të jesh usta duhet të jesh zot në punën tënde**, zot në mallin tënd, në arën tënde, zot i qeve të tu, i hostenit tënd, ashtu siç është samarxhiu, tyxhari, mejhanexhiu, bakalli, zot dyqani e zot malli. Bujku s'është zot as i vetes, se të gjitha janë të beut, edhe pendët, edhe trualli, edhe thara, edhe...E ç't'jua numërojë kur i dini vetë? ..Andaj, vëllezër, ndonëse mbajmë botën në krah, megjithëse kojmë të tjerët me gjithë të mirat e vetë heqim, asnjë nuk na thotë: "Puna e mbarë usta"! (f. 524)*

- *Mos ngit atje ku s'të përket se do ta gjeshe nga s'e prët! (f. 546)*

Karakterizimi i personazheve është jo vetëm në **leksikun e përdorur**, por edhe në **ndërtimin e diskursit, i ngjashëm me atë oral**, popullor. Përsëritja e një fjale, sintagme, vargu ose gjithë pasazhit e strofës është e njohur në këto krijime.

Në roman, gjithashtu hasim, edhe tekniken e vendosjes së përshkrimit të **objekteve** njëra pas tjetrës ose të attributeve pranë njëra-tjetrës, për të krijuar **kontraste të fuqishme** ekspresive. Ky, si procedim, është karakteristike e diskursit të krijimeve popullore, që u ridimensionua fuqishëm edhe nga diskursi i veprave romantike.

Herë pas here, vihet re se rrëfimi, më shumë se i shkruar, i **ngjan strukturave të dialogut të drejtpërdrejtë, të folur**. Strukturat tekstore të romanit janë të ngjashme me gjuhën e folur, të traditës dhe retorikën e saj. Idiomat gojore janë të gjitha kudo të pranishme dhe gjithkund dalin në tekst, **shprehje frazeologjike idiomatike** dhe një mënyrë komunikimi nëpërmjet rrëfimeve sa simbolike aq edhe alegorike, paralele me dukuri të natyrës, botës së kafshëve me të cilën është e lidhur, tipike për diskursin oral.

Leksiku është ana e cila e bën më të dukshme ndikimin nga strukturat gjuhësore gojore. Ndërtimi i strukturave gramatikore dhe sintaksore mes fjalëve, por edhe në mënyrën e ndërtimit të frazave është shumë pranë asaj të komunikimit popullor.

Jakov Xoxa, kur flet për lidhjen me letërsinë popullore, nuk pëlqen të pranojë ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë prej saj, por thekson se gjuha ka qenë ajo që e ka inspiruar.

Kur flasim për gjuhën, vërejmë se Jakov Xoxa ka arritur që, nëpërmjet gërshetimit të diskurseve të ndryshme, të krijojë një tekst inter diskursiv, si ai autorial, që ia lë vendin një diskursi sa realist aq edhe modern të përshkrimit të së përditshmes, për t’u hedhur, madje, deri në tiparet e një kronike historike të kohës për fatin e Shqipërisë. Të gjitha këto diskurse arrijnë të tipizohen unikalisht brenda qëllimit të tij për të endur fatin e njerëzve me të përbashkët traditën, shpirtin shqiptar, vuajtjen të cilën nuk e ndajnë nga kënga dhe jetën e cila konsiderohet e jetuar në bazë të virtyteve sa të pashkruara aq edhe të gdhendura në identitetin e shqiptarit.

Kështu citon edhe Aristotel Mici në lidhje me universalitetin e veprës dhe mbështetjen në popull *“Meritë e J. Xoxës është se ai,*

ndonëse duket sikur merret me problemet e një krahine, **s'ka rënë në letërsinë krahinore**, por ka arritur që çështjet myzeqare t'i ngrerë në **plan kombëtar**, u ka dhënë shpirt e ngjyrë të përgjithshme shqiptare. Kombinimi i rastësisë me domosdoshmërinë është një veçori tjetër në realizmin e kësaj vepre. Një veçori themelore e romanit është realizmi i thellë i jetës. Ky realizëm buron nga intuita e thellë e shkrimtarit dhe kalon në përgjithësim artistik. Vlerat realiste të kësaj vepre rriten shumë, sepse autori ka vendosur një raport të drejtë midis materialit bruto dhe fantazisë krijonjëse. Vendosja e një raporti të drejtë midis këtyre dy burimeve në përpilimin harmonik të një vepre është kërkesë artistike.

"Lumi i vdekur", pikërisht se ka një raport të drejtë midis vëzhgimit dhe imagjinatës, i ka shpëtuar çdo skematizmi, idealizmi të jetës. Në shumë skena realiste J. Xoxa fut tabllora romantike, që ngrihen ndonjëherë edhe në lirizëm duke buruar nga frymëmarrja e gjerë artistike. Kudo lexonjësi ndeshet me atmosferën e poezisë së romanit.²

Intertekstualitetin e romanit si mbështetje ndaj traditës popullore, mund t'i gjurmojmë edhe në planin paradigmatic, që na bën të analizojmë ngjashmëritë dhe bartjet e transformuara ose jo, në tërësinë e temave, subjekteve, në bartjet e personazheve arketip, bartjet e motiveve etj. Përshkrimi i Vitës përngjason me atë të Tanushës, apo Laurës së Petrarkës.

- Muajt që Vita qëndroi mbyllur e kishin zbukuruar më fort. Errësira e kasolles e pati zbehur paksa, sa për t'i rikthyer njomësinë që ia kishte rreshkur dimri dhe për ta bërë më të brishtë. Floku, që se kish prekur as era e as rrezja e diellit kish marrë përsipër një të verdhë të errët, që afrome nga ngjyra e kënasë. Ngjyrimi mes ngjyrës së artë të faqes së sipërme të flokëve dhe fijeve të errëta të shtresës së brendshme që jepnin e mirrnin vetëtitje meneksheje ish zhdukur. Qerpikët e zinj, lëshuar mbi sytë kaleshë e levarashë sikur ishin vënë qëllimisht aty, si frëngjitë e

² A. Mici, Mbi veçoritë ideo-artistike të romanit *"Lumi i vdekur"*, "Nëntori", nr. 2, 1968, Tiranë, f. 177-182.

dritareve për të ruajtur pasurinë që fshinin brenda. Lëkura e bardhë e fytyrës, e parrahur nga era dhe dielli, i pat humbur prenkat e dikurshme. Shtati, i pavarur nga punët e bujqësisë, ish hedhur sa ish hedhur si llastari në pranverë dhe pastaj kish qëndruar sikur priste t'i binte dielli për të marrë sulm të ri. Përkulja pakës përpara që Vita e pat marrë zakon kur fshinte nishanet e vajzërisë, pothuajse që zhdukur. I çliruar tërësisht, trupi pati marë zhdërvjellje si ajo kulpra e pyjeve, tek bën përpjetë të arrijë sa më parë diallin. Më në fund, dashuria sikur i kishte dhënë të drejtë të zbulojë bukuritë e fshehura. Gjijnjtë, të zhvilluar sa nuk fshiheshin dot më në atë kërcimin e tyre përpara, i kishin detyruar shpatullat të tërhiqeshin pas, duke ia drejtuar kështu kurrizin. Megjithatë, ajo ecja e parë gjithë hije nazike, i kish mbetur dhe madje sikur i qe shtuar. (f. 500-501)

- **Përshkrimi i fizikut të Vitës:** Shtatin e kishte si më të vërvitur për moshën e saj dhe për kocën pakës të shkurtër të femrës myzeqare. Këmbët e gjata (ja tani atje në buzë të qerres kërcinjtë e saj të varur jashtë sa nuk merrnin dhë) i dukeshin akoma më të gjatë nën fustanin e vjetër shkurtuar shumë se shumë ishte rritur Brënda këti viti të fundit. Thithat e gjinjtë të vegjël si ai bisku i fasules që ngre kokën e fryn tokën e ardhur nga vakësia e pranverës ia kishin hedhur kraharorin përpjetë. Vetëm kurrizi i merrte pak përpara si ti ishte thyer nga barra e punëve të shtëpisë, por jo, në këtë moshë sak ç'i bën puna shtatit të një vajze si Vita, Shpatullat e mbledhura varfërisht, dhe si për të future e fshehur nën vehte kraharorin e përhedhur do të kenë ndonjë shkak tjetër. (f. 15)

- Pak nga pak fytyra e Vitës këmbëhu **dritë** dhe në këtë këmbim sikur iu brujtën disa tipare të reja të padukura gjer aty. (f. 142)

- **Përshkrimi i Vitës në sytë e Adilit:** Adili humbur në këngët e veta po ndiqte lëvizjet e hijeve të gishtërinjve mbi telat e çiftelisë. Ai se dëgjoi fare atë që po i afrohej. Vetëm kur kërciti një bluashkë nën këmbët e çupës dhe Vita qëndroi përnjëherësh, djaloshi ngriti kokën. **Flaka e zjarrit** e cila ia mbante trupin që poshtë lart e vinte e lozte, pastaj me fytyrën e Myzeqesë sikur e rriste dhe e zgjaste në trup. Kërcinjtë e përhedhur dhe pulpët e këmbëve të mbushura sipër e të

tërhequra poshtë, sikur dora e një mjeshtri ta kishte endur e këputur brumin e tij me një vërtitë të dorës nga lart poshtë; pjesa e kofshëve që linte jashtë fustani i shkurtër nga ujërat e shiut e nga të tharët në **afshin e zjarrit** dhe pjesa tjetër përmbi që zbulonte **drita** e flakës e cila i futej nëpër të; trupi i kolmët, gjinjtë që sapo kishin ngritur kokën në të linjtën që i shtrëngonte keq; fytyra e bukur vezake, me faqet pak të tërhequra, të mbuluara nga **të kuqtë e flaktëve**, vetullat kaleshe, të gjitha këto shto edhe natën me hije, dritat, fshehtësinë dhe tundimet e saj, e mbërthyen në vënd. Vetëm tani, megjithëse ishte e **treta herë** që takonte këtë vajzë, ai ia vuri re bukurinë, një bukuri jo më nishan por si **dritë** që buronte nga të gjithë tiparet dhe mblidhej në një hijeshi të përgjithshme, ashtu siç buron ujtë nga të katërta anët e dheut, e mblidhet në gropën e një gurre dhe të merr sytë nën dritën e diellit. (f. 47)

- *Flokët e myzeqares, shpërndarë nga të bredhurit, njomur nga buckimet e djersës po avullonin tani afshin e tyre të veçante, siç avullon e kundërmon topili me tërfil të thatë sa herë cfurku e merr nga fusha dhe e vërvit mbi qerre. Një hop dhe leshrat e vajzës dhe vrullin e tyre të hedhjes pas, e trazuan kosovarin në gushë, në mjekër e në pushin e hollë të faqeve.* (f. 96)

- *Vajza në çdo çap kafshonte buzët nga përcëllimi. Me hoje mjalti në zemër, me flucka mavi në buzë, me pikë djerse në ballë, e me prush nën këmbë, por pa një kokërr loti në sy, ajo po bënte rrugën e parë që e shpinte larg të dashurit, por pranë e më pranë dashurisë. Baluket e njomura nga djersa filluan t'i rrihnin fytyrën si bishta shëgjetlle. Pështyma ashtu si qeve, nisi t'i mpiksej anë buzëve të rreshkura e të bëra plagë nga lodhja etja, kafshimi. Fytyra e rrahur nga ndjenjat më të ndryshme, dukej sikur ja, edhe një hop e do të fshihej prapa pëllëmbëve të turpit (siç qe fshehur hëna pas një reje) me t'u dukur kavaku i gjatë i oborrit të shtëpisë që s'ishte fort larg.* (f. 101)

- *Suat Bej Vërdhoma qëllloi më i shpejtë. Ia kishte marrë krahun vajzës, e kishte ngritur dhe me majën e kamxhikut, po i shkundte manat e ngjitura nëpër fustan. Duke mos patur ç't'u bëj*

njollave të kuqe e të zeza që kishin lënë kokrrat në basmë e që dukeshin sikur t’ia kishin shtuar lulet, shikonte bujkun me inat. (f. 518)

- Vita më këmbë, ***buzëlyer me të kuq të fortë mani, mollëzaskuqur nga turpi*** që iu zverdhën në çast nga frika, duke bërë kontrast me buzët, jepte e merrte faqe, pa ditur askush se në ç’ngjyrë do të qëndronte. Lotët e mëdhenj, që i shkonin poshtë më tepër nga llahtaria për babanë, se sa nga shembja e putrave që po i mirrin ***gjak*** e po i fryheshin, s’mallëngjyen as beun, as prindin, por ndezën djemtë e Koz Dynjasë dhe Llazin e Karillën, që brofën në këmbë. (f. 518)

Bartjet janë më shumë në **motive, figura arketip, mendësi** jo rrallë, në tekst vërehen qartë elementet e **besëtytnive**, tek të cilat besojnë disa nga personazhet, madje edhe autori e vërteton besimin e tyre duke e plotësuar mendimin me idenë “*Populli është treguar konservator për ruajtjen dhe transmetimin në vijimësi brezave, që të mos zhduken nga asimilimi për shkak të hapjes me botën. Etnografia në të tërë elementët e saj është kulturë kombëtare dhe nga Jakov Xoxa këto tradita janë pasqyruar sa realisht aq edhe me kuptimin e tyre simbolik të identitetit.*”³

“*Në këtë fushë që shkrihet natyrshëm në vepër, pa e rënduar aspak, Xoxa ia del të japë qartazi, përmes trajtimit të tyre si simbole një ndjeshmëri të lartë duke kontribuar në forcimin e karakterit kombëtar, se ato s’janë vetëm krahinore, por të mirëfillta e të dallueshme.*”⁴

Elemente të **oralitetit** vihen re dhe në **mënyrën si paralajmërohet** ajo që do të ndodhë. **Paralajmërohet vdekja, paralajmërohet humbja e virgjërisë, martesë e parealizuar,**

³ M. Shapka (Lëngu), *Simbolika në romanin “Lumi i vdekur” i Jakov Xoxës*, Kritikë Letrare, E Përmuajshme Social-Letrare Botues: Bashkia Fier, Numër 31 korrik 2012.

⁴ M. Shapka (Lëngu), *Simbolika në romanin “Lumi i vdekur” i Jakov Xoxës*, Kritikë Letrare, E Përmuajshme Social-Letrare Botues: Bashkia Fier, Numër 31 korrik 2012.

vdekjet e pamenduara për shkaqe sa biologjike aq edhe natyrore.

Paralajmërimet për atë që do të ndodhë, jepen jo në mënyrë të drejtpërdrejtë; herë jepen në mënyrë simbolike nëpërmjet fenomeneve të natyrës, herë në formën e parandjenjës, e herë nëpërmjet ëndrrës që, shfaqet si teknikë e shpeshtë e tipike për diskutet orale, përrallore e mitologjike. Në këtë roman, kemi bartje të **motivit të paralajmërimit**, që nuk ndryshon aspak nga ato mitike si funksion arketip. Na vjen pa u ndryshuar në tekstin autorial, pa u bërë objekt diskutimi në rrjedhën e ngjarjeve.

Në rrëfimet popullore janë të shpeshta paralajmërimet nga qenie të vdekura, ndërsa në romanin “Lumi i vdekur”, ardhja e vdekjes ose e të keqes paralajmërohet nga vetë personi Rina apo nga simboli i mallkimit, në përputhje me etnopsikologjinë tradicionale. Herë paralajmërimi vjen nga si mjegulli mendore nëpërmjet shfaqjes së imazheve që tregon një lloj intrige ankthndjellëse e herë e papritur. Shpesh herë vdekja sublimohet fuqishëm dhe parashikohet edhe nëpërmjet ndryshimit të motit dhe natyrës, besëtytnive së plakave dhe parandjenjave apo ëndrrave. Ajo çka përkufizohet më pas si element nënvetëdije dhe që Frojdi e shpjegon në kontekstin psikologjik është ëndrra, për të cilën do të diskutojmë më pas. Sipas Samedin Ymerit disa shenja paralajmëruese që shqiptarët i përdorin mjaft si orientim në jetën e tyre janë kur pula këndon si gjel; nuk duhet të pinë **ujë** dy vetë në të njëjtën kohë; nuk duhet të ndezin **zjarrin** dy vetë; nëse ia prët rrugën automjetit i cili niset për në rrugë; nëse ta prët rrugën macja e zezë ose shenjat kur **qeni** ulërin me kokë lart; nëse qeni ulërin me kokën poshtë; nëse të luan syri i majtë; nëse ai që e ka mbjellë pemën e arës dhe kur ajo do të rritet e do të arrijë trashësinë sa e personit që e ka mbjellë; nëse i thua punë të mbarë atij që e gropon varrin; nëse dikush vesh tesha të djegura; nëse dikush vesh tesha të shpuara nga thika; nëse bën larje para akshamit; nuk duhet të pinë dy vetë ujë paralelisht etj.⁵ Për kornizën

⁵ S. Imeri, *Bestytnitë shqiptare nga rrethi i Prilepit dhe i Krushevës*, Shkup, Interlingua, 2007, f. 56-58.

folklorike ku vdekja afrohet me anë të shenjave mund të përmendim disa pasazhe të romanit:

- Gjithë e **premtja e zezë dhe e shtuna e madhe**, kaloi në Trokth me trëndje e shqetësim të thellë. Teto Konxheja, harroi të heqë **vezët e kuqe** nga kusia e bakëmit me bojë, ku i kish hedhur në bojë që të **enjten** dhe ato **erdhën e u nxinë, jo si vezë pashkësh të krishtera, që ishin, po si vezë të paudhësh**. – Oi, unë korba, ç’u nxinë kështu, si katran! Bashkë me të **shtunën e zezë** u bë një edhe **moti i zi?** Oi, pashkë të kuqe me vezë të zeza! (f. 382)

- “Ai që s’po vjen, mos ma kanë vrarë!...” Ky mendim shkrehur në kokë si ajo vetëtimja përmes **reve të zeza**, sikur i hapi nëpër natë, me dritën e vet, shtegun e një bote tjetër. Dhe ajo s’pa më e s’dëgjoi më. Sytë iu mbushën me lot e ia plasi vajit. (f. 607)

- Po sikur të mos jenë takuar? – I rrahu tëmthas ky mendim i llahtarshëm. E **zeza** djali... Klithi, duke mbyllur **sytë** fort. Por, sapo i mbylli, për të mos i dhënë gjallje frikës së vet, iu shfaq Ndoni, në fundin e pusit të errët të syve, gjithë shkrepitima e vezullima, lajle lule, nga ku po i buronin lotë të nxehtë. Pak nga pak në atë **sfond të zi** qëndisur gjithë rrëzëllime, hija e të birit po i merrte trup, fytyrë, qëndrim. I përhumbur në mes të fushës krahënderur si një zogth që s’di nga të fluturojë për të shpëtuar, **iu duk si një kryqth i zi**. Nëna hapi sytë e tmerruar.... Zemra ia ndolli menjëherë: “ata janë”!... I ka zënë vala afër **shënpremtës** dhe i janë mbledhur tek kurrizet. Po **Lumin** qysh ta kenë hedhur?...Pyeti me tërsëllim në zemër dhe zemra i ngriu prap në kraharor. “Sa e marrë që jam! U kanë hipur pelave!...”. t ë k i bëri diçka atje në kërthizë **sikur** ti qe këputur. Ajo që dikur kishte lidhur foshnjen me të dhe jetën, sonte sikur po zgjidhej. “Po sikur të mos jetë mbajtur Ndoni mbi pelë?” dhe zuri prap fytyrën me duar. (f. 338)

- Ka të drejtë Dafina, nënë... Lexi do ketë vajtur në kurriz të **Shënpremtës te pelat**...- dhe Piloja pa nga **nusja**, por kjo kishte rënë përmbys mbi kanavetën e **pajës** dhe po qante me ngashërim. Edhe Pilos, tani që s’e gjeti të **vëllanë** në shtëpi, ia desh zemra të mbështetej diku dhe u mbajt menjëherë tek shpresa e **së kunatës**.-

*Hajde, Dafinë, ngrehu të shkojmë, se me të qarë si dilet dot!... – tundi të kunatën nga shpatullat, sikur të mos mjaftonte shkundja e dënesës. – Nënë, nënë!... E zeza unë!... – U ngrit ajo më gjunjë dhe u zvarrit pas **fustanit të zi të së vjerrës**. – Po pse mos të vinte ai këtu, siç erdhëm ne, pse?... – dhe mbuloi fytyrën e saj me **futën e zezë** të sofrës dhe ia plasi vajit. (f. 352)*

- Tyt moj nuse tyt mos kundo kështu që në mëngjes se është mëkat... do zoti i kam gjallë dhe ata. (f. 332)

Kënga, si pasuri e traditës dhe burim i argëtimit, është simbol i sintezës artistike e oralitetit shqiptar, si përcjellëse e prurjeve kuptimore kur ndërfitet në tekstin e shkruar e në rastin tonë në vlera të shumëfishta. Momentet më të lumtura të jetës së njeriut shoqërohen me këngë, madje ato janë si kujtesë për trimëritë, dhe tek “Lumi i vdekur” sugjerohen si arkitekt, duke lënë shenja të qarta përcaktuese të identitetit tipik shqiptar me trendin për të përfshirë këngën si kult, paralele me poetiken, origjinale dhe shënjon jetën shpirtërore që në stilin xoxian vjen si një zë modern, dashurore, komunikuese. Këngët që këndojnë burrat njëri me tjetrin s’janë gjë tjetër veçse një dialog komunikues i botës së tyre të fshehtë. Në një botë herë të mbyllur e herë të hapur ndaj plotësimit të dashurisë, e vetmja mënyrë për të komunikuar ndjenjat e tyre, dhe për t’i paraqitur ato, është ajo nëpërmjet këngës. Këto vargje **rrëfejnë për erotizmin e fshehur** në një realitet, i cili është i pranueshëm nga të gjithë madje dhe nga fëmijët të cilët ndonjëherë nuk e kuptojnë tekstin por thjesht tërhiqen nga muzikaliteti.

Vargjet e kënduara në romanin “Lumi i vdekur” janë, në shumë raste, objekt që lidhin dialogun, duke u bërë objekt i bisedës, ndonjëherë ato nxisin kujtimet e së shkuarës, duke revokuar emocione të kaluara. Këngët në këtë roman janë përsiatje, meditime, himne dashurie, dhimbjeje, që parathënë atë që lexuesi do të gjejë në rrëfimin për personazhet e veprës.

Mjafton një këngë e kënduar nga të tjerët dhe personazhit i vijnë në mëndje, në retrospektivë, emocionet e bukura e të dhimbshme, madje individët fillojnë edhe filozofojnë mbi jetën, mbi atë që shkon

dhe e humbet e s’kthehet dot më. Në këtë mënyrë arrin në këtë roman, **lirizmi të shkrihet me epizmin dhe dramatizmin.**

Kënga e Adilit ka ngjyrimet shpirtërore nacionale dhe individuale. Ajo përjetohet thellë nga vetë ai dhe kënga e tij natën vonë është identifikuese për praninë e tij. Madje nga personazhi cilësohet se kënga qenka më e fortë se njeriu. Adili edhe pse ngurron të këndojë kur ia kërkojnë burrat teksa prek telat, magjia e muzikës ia çliron drojën dhe kënga e tij çan natën. Kjo këngë përfaqësohet edhe si dialog lirik i cili është një tip i posaçëm i të folurit të gjatë, të personazheve, nëpërmjet të cilit personazhet kumtojnë replika intime, në raportet e tyre reciproke forma më e thjeshtë dhe më e ekspozuar e kësaj mënyre komunikimi të personazheve dhe padyshim është të folurit në vargje të njërit personazh. Vargje të tilla mund të jenë këngë popullore, por në rastet më të shpeshta ato janë vargje të krijuara prej vetë shkrimtarit⁶.

- **Dialog lirik:**

*“Nga na erdhën këta gostivarë,
që na prunë këtë ditë të bardhë, bini ju trimat të rinj!”
“mal në mal e shteg në shteg,
përmbi krah për nga një dyfek,
bini ju trimat e rinj.” f. 44*

Emocionet e brendshme dhe individuale si të Vitës e habitur që një djalë kaq i ri këndon aq bukur, pafajshëm lë gjurmë të pashlyeshme në subkoshiençën e saj si një vlerë, një lloj prehjeje paqësore për Adilin, i cili nuk mundet kurrësi ta shprehë dashurinë e tij ndryshe, ndërsa Vita ngashërehet duke dyfishuar dhimbjen e dashurisë me atë të nënës së humbur. Autori merr vetëm thelbësitë e poetikës së realizmit, ato që janë më të vërtetueshme dhe më efikase për realizmin e një vepre të stilit të tillë. Nga ato thelbësi do të duhej përmendur: konceptionin mbi totalitetin e realitetit të zgjedhur për trajtim, rrëfimin e thellë paralel, aspektin depërtues psikologjik të objektivit realist dhe kategorinë e dilemës në realizimin e

⁶ N. Sopaj, *Romani shqiptar*, NBG, Shkupi, Shkup, 1996, f. 216.

personazheve në planin etik dhe veprues. Të gjitha këto elemente, në roman, dalin të transformuara dhe të plotësuara me aspekte të rezultateve të romanit modern dhe të dijes bashkëkohëse. Kështu nga romani modern autori merr aftësinë e analizës dhe të zbërthimit të brendshëm, e cila varet dhe realizohet më shumë nga ndërtimi i personazheve.⁷

Sjellim në vëmendje këtu mendimin e Aristotel Micit në lidhje me faktin se *“Në letërsinë shqipe. J. Xoxa del si një stilist i zoti dhe mjaft origjinal. Veçoritë e stilit të tij mpleksen organikisht mjaft bukur dhe në këtë vepër e japin qartë filozofinë, individualitetin artistik të J. Xoxës. Zotërimi i shumë komponentëve të formës artistike i ka dhënë mundësinë J. Xoxës, që të shprehë në vepër gjithë filozofinë popullore. “Lumi i vdekur” duket nga kjo anë sikur ka buruar nga psikologjia e myzeqarit, nga gjuha dhe natyra e Myzeqesë. Kudo në roman bie erë Myzeqe.”*⁸ Shumë prej karakteristikave të mësipërme shfaqen si një monument në pasazhet e poshtme të vjelura nga romani:

- *Një zë i rrumbullosur, që dukej sikur vinte e vinte anës tij, pa u shpëputur dot e të merrte pastaj fushën, lëmohej e ndjehej e lëshohej aty, me të këputur e sipër e humbiste përtej gardhit:*

*“këto ke shtylla moj lale,
këtu në der-ë,
po vjen çika,
moj lale, ylyvere...
o po vjen çika, moj lale, ylyvere...
dal ka dal, mori çike,
mos u ngute,
se në zemër, moj çike,
më ke kput -e.
O se në zemër moj çike,*

⁷ I. Rugova, *Strategjia e kuptimit*, “Realist i kulluar i realizmit të madh” (filozofia jetësore e “Lumit të Vdekur”), f. 28 – 36.

⁸ A. Mici, *Mbi veçoritë ideo-artistike të romanit “Lumi i vdekur”*, “Nëntori”, nr. 2, 1968, Tiranë, f. 177-182.

me ke kput-e” (f. 44)

- **Ja mori një avazi të bukur myzeqar:** “*Të zbardhonte gusha, si topi i sheqerit.*

Moj goc’e berberit!” (f. 154)

- **Kishte dalluar atje te qytetin e bardhë të Fierit:** “*ma kishe shtëpinë në të dalë të Fierit. Moj goc e berberit.*” (f. 154)

- **Kur Piloja mbaroi qehajabashi ja mori një këngë myzeqare:**

*“te çezm e Shënkollit se ç’ta bënë varrë,
O Zengal, o zullumqar!
Ta bënë Shpiragajt, ndotësa myzeqarë,
o zengale o gjynahqar!” f. 450-451*

- **E gjithë rrugës kishte kënduar këtë këngë:**

*“me det kjo vera ç’mu mërzit o shokëni!
se çel gjithmonë po ato lule o shokëni!” (f. 452)*

- **Beu, ja ktheu ndryshe këngës:**

*“bre, kjo vera ç’më pertit, o shokëni!
Se nuk çel po ato lule, o shokëni!
Ç’vysk dimri nuk çel pranvera o shokëni!
Po termon hapin të tjera, o shokëni!” (f. 453)*

Ndërkohë vuajtjet, kënaqësitë, dhimbjet, emocionet e dashurisë a të humbjes së saj, bëhen pjesë e njerëzve, duke njohur thellësitë psikologjike të popullit shqiptar, shpirtin paqedashës që e duan dhe kanë nevojë për këngën. Kënga mund të simbolizohet me fluiden, me ëndrrën syhapur që të shokon dhe gjen shtigje medituese.

- **Le, le do ta kishte gjetur zavallin xha Limon si puna e atij që i kanë ngritur këngën:**

*“oj, oj se pësoi.
Pilo Plaka në Topojë,
Preu hundën tek e rroi,
Vajt e shoqja e qortoi” (f. 515)*

- **Korrësit, pa arritur tek hendeku i kolumbrive, atje ku do të ndaheshin për të marrë secili arat e veta, dëgjuan një këngë, që vinte nga gruroret e muhaxhirëve:**

*“mos mi lidhni sytë me shami
se jam shqypar, kosovarli!” (f. 520)*

- **Zu të këndoje e të përdridhet:**

*“burri i ve
Nusja e ve
Do na bëjnë
Koqe ve...” (f. 554)*

Rrëfimtari, në lidhje të ngushtë me personazhet paraqit plotësisht dhe dëshirat e botës së brendshme gjithsecilit prej tyre, në ambiente sociale, si realitete jetësore.

- Myftari i Veshnjes si vendosi mirë paguren e rakisë mbi prehër, ja mori vetë i pari:

*“bëj një dru me përcëllime
Moj leshverdha trëndeline.” (f. 569)*

Jakov Xoxa në raport me firmën e tij autoriale është tolerant, gjithëpërfshirës, shqiptar, me shumë elemente kronotopike si dhe shumë fakte reale, historike, referenciale dhe këngën e përvetëson dhe e prezanton njëherësh si një katarsis shpirtëror, universale dhe të ndjeshme nga të gjithë.